*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

E hënë, 27 nëntor 2023

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.31

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Së pari, dëshiroj që të prezantohen të pranishmit.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mirëdita. Për ZPS-në Line Pedersen, Federica Genovesi, Filippo De Minicis dhe Gaia Pergolo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Mbrojtës i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita. Jam Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave për këtë çështje gjyqësore, së bashku me bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

Z. GILISSEN: [Përkthim]. Mirëdita, e nderuar Gjykatëse.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

Jemi këtu së bashku me z. Shala. Është gjithmonë lajm i mirë që e kemi z. Shala së bashku me ne që e ndjek këtë seancë. Bashkë me mua është z. Hedi Aouini, Leto Cariolou, Juliette Healy dhe Judit Kolbe. Dhe znj. Dzeneta Petravica pati probleme pak para seancës, do të vijë më mbrapa, është duke ardhur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.

Mirëmëngjesi, z. Shala.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju dëgjoj shumë mirë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit Ekspert të Mbrojtjes, DW4-03, z. Andre De Viliers Horne. Do të dëshmojë në Gjykatë pa masa mbrojtëse. Do të kemi tri seanca të rregullta nga një orë e gjysëm me pushimet si zakonisht. Në përfundim, do të lëshojmë një urdhër procedural gojarisht për hapat e ardhshëm procedural.

Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit në cilësinë e ekspertit, vërej se të premten që shkoi kemi marrë email nga Mbrojtja ku janë dorëzuar dy materiale të cilat ZPS-ja synon t'i përdorë me Dëshmitarin DW4-03 të cilat janë nxjerrë po atë ditë dhe që duheshin nxjerrë shumë më herët gjatë gjykimit. Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykues që të udhëzojë ZPS-në të vijojë me shqyrtimin e materialeve që ka në

zotërim dhe të cilat kanë lidhje me çështjen gjyqësore në mënyrë që të sigurohet një gjykim i drejtë dhe të respektohen të drejtat e të akuzuarit.

Znj. Prokurore, nëse dëshironi të përgjigjeni dhe se dëshironi të kalojmë në seancë private?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, s'ka nevojë të kalojmë në seancë private.

Shkurtimisht ky material është identifikuar në databazën shumë të madhe që ka ZPS-ja. ZPS-ja nuk e ka pasur për synim që mos ta nxjerrë këtë material. Ne parashtrojmë që nuk duhet të ketë shkaktuar cenim sepse materiali në fjalë është objekt i materialeve të tjera që janë nxjerrë në të shkuarën. Por ne do të bëjmë çmos që të shqyrtojmë në vazhdimësi materialet që kemi në zotërim dhe të parandalojmë që kjo të ndodhë në të ardhmen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Mbrojtës i Viktimave, keni ndonjë gjë për të shtuar?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës. Faleminderit.

Ne, të nderuar Gjykatës, i qëndrojmë kërkesës tonë dhe ju nxisim që të udhëzoni ZPS-në që të bëjnë çmos --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, nuk dua përsëritje. Këtë e dimë. Nëse keni diçka të re për të thënë, ju lutem, por ato që i keni shkruar, unë i kam lexuar dhe janë shumë të qarta.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Unë e thashë këtë sepse kemi marrë edhe një material tjetër më pas që është material shfajësues për një tjetër dëshmitar. Dhe, nëse shohim datën dhjetor 2022 dhe po të shikojmë rrethanat e këtij dëshmitari, ky dokument duket qartë se është material shfajësues dhe vetëm pas kërkesës së Mbrojtjes e kemi marrë këtë material para disa ditësh. Është një material shfajësues i cili do të duhej që të ishte nxjerrë menjëherë. Ne jemi të shqetësuar sa i takon analizës që i bëjnë kolegët tanë tek ZPS-ja sa i takon asaj se çfarë materiali mund të nxirret dhe çfarë duhet nxjerrë menjëherë. Ky është një dëshmitar, të cilit i është dërguar fletëparaqitja dhe na vjen shumë keq që kemi marrë një informacion të rëndësishëm të lidhur me të akuzuarin nga ky dëshmitar pak ditë para se ky dëshmitar ftohet në gjyq. Ne i kemi kërkuar ZPS-së që para një viti dhe kemi bërë kontakte dhe informacioni duket qartë që është i tillë që duhet të na i kishin vënë në dijeni menjëherë. Është një material shfajësues të cilin do të duhet ta kishin nxjerrë.

Edhe një herë kjo ritheks on faktin se këto duhen shqyrtuar edhe duhen zgjidhur.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, për procesverbalin ju lutem na jepni numrin elektronik të provës ERN.

Z. AOUINI: [Përkthim] Është me numër ERN 109097. E kemi përfshirë në numrin 14 në listën e materialeve të Mbrojtjes për Dëshmitarin W4280.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra, në listën e materialeve që do përdorni?

Z. AOUINI: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t’i kthehemi kësaj pike më mbrapa. Më vonë do t’i kthehemi kësaj pike, siç ua thashë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës, po përpara fillimit të këtij dëshmitari, duam të themi se sapo e kemi mbaruar takimin me këtë ekspert, para pak minutash dhe kjo është arsyeja pse znj. Petravica nuk ka mbërritur ende në sallë. Nuk kishim kohë që t’i njoftonim kolegët tani kur hymë në sallë. Ky ekspert ka bërë një provë të videos, të një videoje pra, në një poligon qitjeje, na e ka dhënë para pak minutash. Dhe nuk patëm mundësi të marrim prej tij rezultatet e provës së qitjes që e ka kryer ai. Znj. Petravica, menaxhere e lëndës, po i përpunon këto materiale në zyrën lart për t’i nxjerrë sa më shpejt këto materiale. E kemi udhëzuar që ta dërgojë me email dhe t’u jap mundësi që të hyjnë në material të gjithëve, po ka një problem me

dimensionin e materialit të bashkëlidhur. E them këtë për në funksion të nxjerrjes. Këtë do ta bëjmë sipas mundësisë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t'ia jap fjalën edhe ZPS-s. Por nuk e di nëse e ka domosdoshmëri që të kemi diçka më shumë kohë në dispozicion. Do të përpiqemi që ta organizojmë këtë gjë. Dhe ju do të sqaroni më tej pse rezultatet po përpunohen vetëm tani nëse është bërë prova sot a dje, nuk e di. Nuk e kam të qartë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk ishim në dijeni se eksperti e ka bërë këtë provë, e kishte bërë këtë provë. Ai ka përdorur një poligon qitjeje ku herë pas here bën prova, sipas nevojave që ka për dëshmitë që duhet të japë dhe u vu në dijeni të këtij materiali vetëm para pak minutash kur bëmë takimin e sotëm me të. Nuk kishim dijeni.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, këtë e mora vesh, që nuk kishit dijeni, por ai vetë kishte dijeni që do dëshmonte në Gjykatë. Mbase nuk është momenti që të flasë pa u dhënë fjalën dhe palëve të tjera dhe Mbrojtësit të Viktimave, po nuk është ky momenti që dëshmitari ta informojë palën thirrëse për këtë.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Nëse mundem. Pas takimit ditën e premte ai mendoi se për të ilustruar atë që donte të shpjegonte, mënyra më e thjeshtë ishte ta tregonte me video duke qëlluar me Kallashnikov në një poligon qitjeje. Kjo është arsyeja. Është thjesht për të ilustruar diçka për të cilën do

të flasim gjatë dëshmisë së tij.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Videon do ta shohim gjatë pauzës dhe do të shohim pastaj se ç'kanë për të thënë ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave përpara se të marrim një vendim.

Znj. Prokurore, sa i takon materialit që lidhet me dëshmitarin tjetër në radhë, dëshironi që të përgjigjeni tani apo dëshironi që t'i hidhni një sy dhe më pas të përgjigjeni?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Materiali është një shënim zyrtar i bashkëbisedimit me dëshmitarin e ardhshëm. Ky dëshmitar nuk ka thënë asgjë në deklaratat e tij që bien ndesh me atë që është shkruajtur në shënimin zyrtar. Pasi kemi bërë shqyrtim të dokumenteve që do të përdornim me kundrapyetjet me këtë dëshmitar, identifikuam si material shfajësues duke pranuar njëkohësisht që kjo nuk i shkakton cenim Mbrojtjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Mbrojtësi i Viktimave, ndonjë gjë që doni të parashtroni?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, doni të shtoni diçka lidhur me atë për të cilën sapo foli ZPS-ja tani?

Z. AOUINI: [Përkthim] Për të evituar përsëritjet, është material shfajësues. Ka pasur një moment kur ne kemi dashur që të kontaktojmë këtë dëshmitar, është material shfajësues.

Rregullat thonë që duhet të nxjerrë menjëherë. Kaq kisha për të thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Atëherë do të vijojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit 03.

Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

Znj. Prokurore.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Sa i takon materialit të përmendur nga Mbrojtja sa i takon videos, pra, që ka vendosur në dispozicion dëshmitari me cilësinë e ekspertit nëse Trupi Gjykues dëshiron që ne të bëjmë komente tani apo t'i bëjmë më vonë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani po hyn dëshmitari në sallë dhe do të më duhet t'ju ndërpres pastaj, sepse nuk preferoj që ta diskutojmë këtë në momentin përkatës.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mund të flasim edhe më vonë. Po thjesht deshëm t'ju themi që duam që të komentojmë për këtë. Faleminderit.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Shoqëruese.

Z. Dëshmitar, mirëmëngjesi dhe mirë se keni ardhur në Dhomat e Specializuara.

DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala e dëgjoni dëshmitarin apo përkthimin të paktën? Z. Shala, e dëgjuat dëshmitarin?

Kemi humbur lidhjen, na është ndërpretë lidhja me z. Shala.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po përpiqemi që të rivendosim lidhjen, do të presim edhe disa minuta, besoj do të zgjidhet.

Për procesverbalin vërej që znj. Petravica ka hyrë në sallë.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi një problem teknik i cili besoj se do të zgjidhet shpejt. Por është më mirë të bëjmë një ndërprerje të seancës. Kështu që do t'i lutem asistentes së sallës që ta shoqërojë sërish z. Dëshmitar, për të dalë nga salla - ju kërkoj ndjesë për këtë – shpresoj që do të rishihemi pas pak.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni fjalën.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di nëse është ky momenti për të diskutuar komentet nga ZPS-ja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, jo, ndërkohë që ju po flisnit, unë kisha të njëjtën ide, mendoj që është momenti i duhur, që edhe pa praninë e z. Shala, duke qenë se është i pranishëm i gjithë ekipi i Mbrojtjes së tij, mund ta bëjmë këtë diskutim. .

Znj. Prokurore, keni fjalën.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Thjesht për hir të procesverbalit duam që të përmendim shqetësimin tonë lidhur me vonesën e nxjerrjes së materialit. U bë takim të premten me ekspertin ose së paku, Mbrojtja ka qenë në dijeni se mbase do të mund të shtonin disa materiale në listën e tyre për këtë dëshmitar, kështu që idealja do të ishte që këto materiale t'i kishim marrë së paku të djeshmen e seancës kur do të dëshmonte ky dëshmitar, të paktën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Mbrojtëse.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Ne nuk kishim dijeni që do vinte ky material. Ishte thjesht një ide e ekspertit për të ndihmuar, për të na ndihmuar neve, Trupin Gjykues dhe të gjithë për të kuptuar atë që do të shpjegonte ai.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Avokate e Mbrojtjes.

Ka ZPS-ja diçka për të shtuar?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës. Për aq

sa ky është material shpjegues, nuk kemi kundërshtim. Por nëse do të shtonte diçka të re, do të ishte më problematike sigurisht. Por ne e kuptojmë, i kuptojmë rrethanat. Kaq kemi për të thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Mbrojtës i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Ne e kuptojmë që nuk është faji i kolegëve tanë që zotëria ka ardhur sot me një material, i cili mendon se do të na ndihmojë, thjesht është problemi është se çfarë ka ky material dhe a do të ketë nevojë për kohë për ta parë, për ta shqyrtuar pra. Kështu që e rezervojmë edhe në qëndrimin tonë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Atëherë derisa të zgjidhet problemi i videolidhjes me z. Shala, të zgjidhet, bëjmë këtu ndërprerjen e seancës.

--- Seanca ndërpritet në orën 09.52

--- Seanca rifillon në orën 09.59

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u rikthyet.

Z. Shala, mirë se u rikthyet. Dhe ju shoh që videolidhja është rivendosur. Më dëgjoni mirë tani?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

në rregull. Do të vijojmë aty ku e lamë.

Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin të hyjë në sallë. Faleminderit.

Faqja 10. Rreshti 22, ka një 6, shifër 6 në mes të rreshtit që duhet hequr. Thjesht një korrigjim i procesverbalit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mirëmëngjesi përsëri. Përsëri ju urojmë mirë se ardhjen në Dhomat e Specializuara. Ku do të përpiqemi që të vazhdojmë.

Më dëgjoni mirë?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala, e dëgjoni dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, si jeni sot?

DËSHMITARI: [Përkthim] Mirë, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj si ekspert. Përpara se të fillojmë kam disa gjëra për t’jua thënë.

Ju kanë thirrur që të dëshmoni përpara Dhomave të Specializuara në çështjen Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës për ta ndihmuar Trupin Gjykues për të marrë një

vendim. Fillimisht do t'ju bëj pyetje Avokati i Mbrojtjes, ekipi i veshur me rrobë të kuqe. Pas së cilës do t'ju bëjnë pyetje Zyra e Prokurorit të Specializuar, Mbrojtësi i Viktimave dhe, në fund, mund të ketë pyetje nga Trupi Gjykues, megjithëse mund të ndodhë që Gjykatësit t'ua bëjnë pyetjet edhe gjatë dëshmisë suaj.

Përpara se të bëni betimin solemn për të thënë të vërtetën - më falni - jo, edhe një herë. Përpara se të bëni betimin solemn do t'ju jap disa udhëzime, disa këshilla praktike.

Sa u takon udhëzimeve, dëgjojini me kujdes secilën pyetje. Nëse nuk e kuptoni lirisht mund të kërkoni që pyetjen t'jua përsëritin. Dëshirojmë që ju jepni njohuritë tuaja si ekspert në maksimumin e dijeve dhe njohurive tuaja dhe të thoni se cilat janë konstatimet dhe mendimet tuaja.

Ju lutem përgjigjuni vetëm pyetjeve që jua bëjnë, nëse duan më shumë sqarime, do t'jua kërkojmë këtë.

DËSHMITARI: [Përkthim] E kuptoj këtë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

Kam disa këshilla praktike. Çdo gjë që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet, prandaj është shumë e rëndësishme që të flisni afër mikrofonit, të flisni ngadalë, të flisni qartë. Për t'i dhënë mundësi stenografëve dhe përkthyesve që të shënojnë gjithçka dhe të thonë gjithçka që thoni ju.

Kur t'ju bëhet një pyetje, mirë do të ishte që të

prisnit, për shembull, pesë minuta [sipas përkthimit] pastaj të filloni të flisni. Kjo u jep mundësi përkthyesve që ta mbyllin, ta përfundojnë përkthimin e fjalisë që kanë nisur dhe pastaj t'ju dëgjojnë juve.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E them këtë sepse shpesh na qëllon që folësit flasin po ne nuk kemi asgjë të shënuar në procesverbal.

Nëse keni pyetje ju lutem ngrini dorën dhe unë do t'ju jap fjalën. Nga ana tjetër nëse e ngre unë dorën, ju lutem mos flisni më. E bëj këtë gjë, pra, këtë gjest, në mënyrë që unë të mos flas, të mos kemi dy persona që flasin njëkohësisht.

Mund t'ju kërkohet që të përdorni dhe atë lapsin e kompjuterit për të bërë ndonjë shënim, për të shënuar diçka në ekranin që keni përpara. Mund të ndodhë që t'i kërkoj Asistentes së Sallës që t'ju shoqërojë të dilni nga sallë, nëse do ketë nevojë që palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe Trupi Gjykues të diskutojnë për ndonjë çështje në praninë e së cilës ju nuk duhet të jeni.

Është po kështu shumë e rëndësishme që të mos cekni emra të cilët janë konfidencial.

DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Z. Dëshmitar, do t'ju lutem tani që të bëni betimin solemn, ju rikujtoj se përbën vepër penale në juridiksionin e

Dhomave të Specializuara dhënia e dëshmisë së rreme. E kuptoni?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Shumë mirë. Z. Dëshmitar, ju lutem lexoni tekstin që ju kanë vendosur përpara.

DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do ta kryej analizën si ekspert në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me aq sa di dhe se do të jap përfundime dhe mendime të sakta dhe të plota.

DËSHMITARI: ANDRE DE VELLIERS HORNE

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar. Jeni tani nën betim. Mund të rifillojmë me dëshminë e ekspertit. Do t'ia jap fjalën Avokatit të Mbrojtjes që të fillojë me këtë.

Znj. Avokate, keni fjalën.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Faleminderit.

Pyetje nga znj. Cariolou:

[Dëshmitari përgjigjet përmes përkthyesit]

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim]

PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Më quajnë Leto Cariolou dhe do t'ju bëj disa pyetje në emër të z. Shala i cili është i akuzuari në këtë çështje gjyqësore.

Së pari, ju lutem, konfirmoni emrin dhe mbiemrin.

PË. Më quajnë Andre De Villiers Horne.

PY. Vendlindja dhe datëlindja?

PË. Kam lindur më 1 gusht 1961, në Springs të Afrikës së Jugut.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Avokate, ngaqë po flasim në anglisht, do të ishte mirë që të ndjekim një ritëm më të ngadaltë, për arsyet që unë tashmë i shpjegova.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Ju lutem, çfarë arsimi keni? Ku keni studiuar dhe cilat tema dhe lëndë i keni studiuar?

PË. Kam diplomën universitare të ciklit të parë në shkenca mjekësore. Pastaj jam diplomuar edhe si mjek ligjor pasi ndoqa programin formues 3-vjeçar. Më pas kësaj kam ndjekur një program të avancuar në kriminalistikë, kryesisht në balistikë kriminalistike.

Formimi dhe përvoja ime përfshijnë identifikimin dhe klasifikimin e armëve të zjarrit dhe municionit, këqyrjen e mekanizmave të armëve të zjarrit, balistikën e brendshme, të jashtme dhe atë terminale dhe këqyrje e avancuar siç janë krahasimet mikroskopike, interpretimi i dëmit, qitje aksidentale dhe qitja kundër strukturave të ndryshme dhe këqyrje të ndryshme kriminalistike.

Kam ndjekur kurse të ndryshme dhe seminare të ndryshme sa i takon kriminalistikës, armëve të zjarrit dhe kam bërë

rikonstruksion të incidenteve të ndryshme me armë zjarri.

Kam studiuar balistikën e plagëve të armëve të zjarrit. Kam bërë konsulta me mjekë patologë. Dhe në funksion të studimeve të mia, kam kryer prova të ndryshme për të studiuar efekte të ndryshme terminale të predhave.

Jam anëtar i Shoqatës së Ekzaminuesve të Armëve të Zjarrit. Jam instruktor i kualifikuar i armëve të zjarrit dhe kam qenë edhe oficer i poligonit të qitjes. Po kështu jam instruktuar edhe në armët elektrike.

Po kështu jam formuar dhe kam përvojë edhe në profesione të ngjashme me këtë fushë. Kam kryer mbi 3000 këqyrje apo çështje që kanë të bëjnë me këqyrjen e armëve të zjarrit. Kam dhënë dëshmi në gjykatat e Britanisë së Madhe. Kam dhënë po kështu dëshmi edhe në gjykata ndërkombëtare në Afrikën e Jugut, në Qipro, në Ishujt Kaiman dhe kam dhënë dëshmi edhe për gjykatën e lartë holandeze.

PY. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kuptova që keni bërë një përzgjedhje, z. Dëshmitar, nga CV-ja juaj. Pashë që ju po lexonit nga diçka, nuk isha në dijeni ose më saktë nuk isha informuar që keni marrë diçka me vete. Keni ndonjë bllok shënimesh përpara jush?

DËSHMITARI: [Përkthim] Kam shënimet e laboratorit dhe të çështjes përkatëse, i kam përpara.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

Faleminderit.

Znj. Avokate, mund të vazhdoni.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, ju lutem i tregoni Trupit Gjykues çfarë materiali ju ka dhënë Mbrojtja për të përgatitur relacionin tuaj, aktekspertizën?

PË. Më kanë dhënë dokumente të shumta të cilat janë transkriptim i dëshmive të dhëna nga dëshmitarët në këtë çështje gjyqësore. Ku përfshihet dëshmi nga viktima dhe nga persona të tjerë të përfshirë në këqyrjen e tyre, siç janë për shembull mjekë patologë dhe mjekë ligjorë, më është kërkuar që t’i studiojë këto në mënyrë që të jap opinionin tim lidhur me to.

PY. Faleminderit.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke pasur parasysh masa mbrojtëse, me lejen tuaj, propozoj që të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

PY. Z. Horne, a mund të na shpjegoni mënyrat e ndryshme të përdorimit dhe të funksionimit të Kallashnikovit?

PË. Kam përshtypjen që e keni fjalën për një pushkë automatike Kallashnikov, apo jo? Atëherë do vazhdoj që të jap mënyrat e ndryshme të funksionimit të Kallashnikovit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për këtë e kishit fjalën, Avokate?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

DËSHMITARI: [Përkthim] Kallashnikovi njihet si pushkë sulmuese dhe kjo do të thotë që ka një zë ose, le të themi, ka një pjesë, një çelës të cilin ti mund ta vendosësh ose në mënyrë automatike ose gjysmë-automatike. Pra, kur ti e vendos atë programimin tek pjesa gjysmë-automatike do të thotë që ti duhet që ta shkrepësh një herë pushkën në mënyrë të tillë që të mund të shkarkohen plumbat njëra pas tjetrës. Ndërkohë që

në qoftë se përzgjedhja është në mënyrë automatike, kjo do të thotë, që, në qoftë se ju e keni të shtypur atë armën do të thotë që arma do të vazhdojë që të nxjerrë në mënyrë automatike plumbat deri në momentin kur ju ta keni lëshuar atë.

Ndërkohë që selektori në vetvete ka edhe një siguresë dhe në qoftë se e keni të kaluar tek siguresa automatike atë pushkën ose automatikun, kjo do të thotë që e keni të sigurtë pushkën dhe nuk mund të qëlloni.

PË. Faleminderit. Sa i takon tingullit, a është e thjeshtë që të identifikohet se në çfarë mënyre po përdoret Kallashnikovi, domethënë, sa i takon zhurmës që prodhohet nga arma?

PË. Në qoftë se, pra, Kallashnikovi i lëshon plumbat njëra pas tjetrës ka lloj pauze nga njëri tek tjetri, domethënë, sa më shpejt që ti e shkrep armën, domethënë, kjo është shpejtësia me të cilën ti mund të gjuash plumbin. Dhe kjo në fakt varet nga qëlluesi ose nga personi që e përdor armën.

Ndërkohë, në qoftë se, arma është në mënyrë automatike, atëherë municioni shkarkohet ose plumbat shkarkohen në mënyrë të tillë që pak a shumë gama ose koha që kalon nga një shkrepje tek tjetra është 10 sekonda, është shumë shpejt në fakt kjo. Është më shpejt sesa po të ishte arma në funksionim gjysmë-automatik dhe në qoftë se do të duhej që të bëje shkrepje njëra pas tjetrës.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Sot paradite na keni dhënë

një video që e ilustron këtë që sapo e thatë.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Në qoftë se na lejon Trupi Gjykues, mbase është momenti i përshtatshëm tani për ne të gjithë për të parë këtë video.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për të qenë e sinqertë, do kisha parapëlqyer që së pari ta kishim parë vetë videon dhe pastaj të vazhdonim më tej me pyetjet që kanë të bëjnë lidhur me të. Megjithatë e kuptoj që kjo është mënyra, kjo është sekuenca ose radha e bërjes së pyetjeve. E kuptoj këtë gjë, domethënë, kështu e keni programuar ose planifikuar pyetjet që doni që t'i bëni dëshmitarit. Megjithatë në qoftë se mund ta riorganizoni ndryshe pyetjet, unë personalisht do e parapëlqeja që të shikoja videon, ta shikonim të gjithë ne videon më përpara sesa të mund t'i bënit pyetjet dëshmitarit.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, po mund të vazhdojmë me pyetjet e tjera dhe pastaj mund t'i bëjmë pyetjet në një moment tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Do shikojmë videon gjatë pushimit dhe pastaj pas pushimit mund t'i bëni pyetjet që kanë të bëjnë me këtë video.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

PY. Sa e thjeshtë është që të kesh një objekt një shënjestër *[REDAKTUAR]* me një Kallashnikov që është në mënyrën e funksionimit në mënyrën automatike të plotë?

PË. Pushkët të llojit AK-47 kanë shtjegëza. Shtjegëzat janë në pjesën e pasme dhe pjesën e përparme të armës. Dhe në mënyrë të tillë që ti të gjuash shënjestrën, duhet që të jesh në një vijë. Dhe, ndërkohë, shtjegëzat që janë në fund fare, janë të tilla që ti mund të qëllosh me saktësi në një pikë të tillë, për shembull, 400 metra, 200 metra, 300 metra, domethënë, ka disa elementë ose disa faza që mund t'i zbatoni në varësi të sa larg e keni shënjestrën tuaj.

Kur gjuani në drejtim të shënjestrës, aftësia për të

gjuajtur tek pika ku synon të gjuash është që të shkrepësh pa e ndryshuar vështrimin tuaj. Është e thjeshtë që t'i ta linjëzosh ose ta kesh në një drejtim vështrimin, por në mënyrë të tillë që vështrimin ta kesh në të njëjtën vend me shënjestrën dhe të shkrepësh automatikun ose pushkën, kjo është aftësia e qëlluesit. Sepse në qoftë se bën dhe lëvizjen më të vogël mund të ndryshojë drejtim plumbi dhe kështu që nuk gjuan në drejtim të shënjestrës.

Dhe zakonisht kjo është diçka e cila realizohet në qoftë se ke shumë kohë për të gjuajtur dhe në qoftë se ti gjuan me plumba individualë.

Por, në qoftë se pushka është në mënyrën automatike të funksionimit, atëherë i takon që ti duhet që të merresh me zmbrapsjen e armës. Është ligj fizik, domethënë, në qoftë se plumbi shkon në pjesën e pasme të pushkës me një shpejtësi të caktuar atëherë pushka reagon sepse shkon zmbrapset ose bën veprim pas përpara sesa të qëllohet. Dhe në qoftë se pushka ose instrumenti gjuajtës është në mënyrë automatike, siç e thashë edhe më përpara, shpejtësia është shumë e konsiderueshme. Domethënë, e thashë edhe më përpara që është rreth 10 sekonda hapësira nga qëllimi i një plumbi tek tjetri dhe zakonisht, domethënë, përpara sesa t'i bësh ripozicionimin plumbi tjetër ka dalë nga pushka. Dhe, si rezultat, ti nuk mund të gjuash me saktësi tek shënjestra juaj në qoftë se pushka është në mënyrën automatike e programuar. Ndërkohë që

arma AK-47 ka tendencë që të fillojë që të bëjë sprapsje pas ose lëvizje pas dhe në të djathtë në qoftë se juve qëlloni në mënyrë automatike.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*[Seancë e hapur]Riklasifikuar në bazë të F793* E tani përderisa ju jeni dëshmitar ekspert dhe keni përvojë në këtë fushë, dua t'ju bëj pyetje në qoftë se është e thjeshtë që të bëhet dallimi ndërmjet një Kallashnikov ose Uzi ose një Skorpioni?

PË. Për dikë që nuk e ka idenë e armëve mbase është e vështirë që të bëhet dallimi. Megjithatë për persona që gjenden në mjedis ushtarak, unë mendoj, që këta njerëz do kenë qenë ose në një situatë të tillë, në një mjedis të tillë ishte e thjeshtë për të identifikuar se cila armë është.

Sepse AK-47 është më e madhe. Ndërkohë është një armë e

rrumbullakët. Ndërkohë që Uzi është mesatare në madhësi. Ndërkohë që sa i takon Skorpionit, Skorpioni është goxha më e vogël sesa Uzi. Uzi ka kapacitet 9-milimetër, 9 milimetër. Dhe ka aftësi shkarkimi 32 ose 7.65 me kalibër plumbash.

Unë personalisht jam ekspert në këtë fushë. Kështu që për mua është e thjeshtë për të bërë dallimin ndemjet këtyre armëve të ndryshme. Megjithatë, unë personalisht mendoj që persona të cilët janë të përfshirë ku ka të pranishme pajisje ushtarake që edhe këtë persona dhe në gjendje që të bëjnë dallimin e një arme të një lloji nga një armë të një lloji tjetër.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Përpara se të vazhdojmë me këtë linjë pyetjesh, do kërkoja që të kalonim dhe të shikonim faqen 28, rreshti 4. Ju lutem, a na e shpjegoni pak armën gjysmë-automatike ose nën-automatike. Mund të na e thoni pak se çfarë është një armë e tillë?

DËSHMITARI: [Përkthim] Patjetër, të nderuar Gjykatës. Pra, kur flasim për pushkë, pushka është një pushkë e cila gjuan plumba me kalibrin e pushkës. Ndërkohë që sa i takon armëve gjysmë-automatike, pra, janë nën-automatik ose, pra, sa i takon automatikut ato kanë dy versione, domethënë, kanë versionin që mund të punohet ose mund të përdoret arma me versionin gjysmë-automatik dhe me mënyrën automatike të plotë. Dhe ky është dallimi kryesor ndërmjet një -- domethënë, ndërkohë kemi armën automatike. Arma automatike mund të

përdoret me municion, pushkë e dorës krahasimisht me municionin që përdoret për pushkët ose armët e zakonshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani do bëjmë një pushim 45 minuta, pas së cilit do të kthemi dhe me vendimin lidhur me videon që u prezantua nga Avokatja Mbrojtëse për t'u parë dhe me qëllim që t'ju kërkonte komentet tuaja lidhur me të, ne do marrim mendimet të Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtësit të Viktimave. Pastaj do veprojmë në vijim. Faleminderit për momentin.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëhere takoni në 12.00 pa 15.

Seanca ndërpritet.

--- Pauza fillon në orën 10.57

--- Seanca rifillon në orën 11.47

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se vini. Shoh që ZPS-ja ka të njëjtën përbërje, e njëjta gjë për Mbrojtësin e Viktimave në anën time të majtë. Kemi të njëjtën përbërje siç ishte përpara pushimit.

Përpara që të sjellim dëshmitarin në sallë apo të komunikojmë vendimin tonë lidhur me videon, kam diçka që dua

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

të diskutojmë.

Dhe për këtë kërkoj znj. Sekretare të na kalojë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Përpara që të thërrasim dëshmitarin në sallë, znj. Prokurore, keni ndonjë kundërshtim që Mbrojtja të përdorë videon e nxjerrur rishtazi?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kërkesa ime për ju, Avokate Mbrojtëse, është që në qoftë se

mundeni t'i kërkoni dëshmitarit ekspert që të konfirmojë, sepse kështu e kuptova unë, se shënjestrat apo vijat e shënjestrës janë në fakt rezultat i të shtënave në video, sepse mendoj që kjo është ajo që do të thotë, por nuk -- ndoshta do të ishte mirë që të kontrollojmë edhe një herë.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Kuptoj, mund ta qartësojmë atë me të.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jam e sigurt që mund ta bëjmë këtë.

Atëherë, tani, do të thërrasim dëshmitarin në sallë.

Znj. Punonjëse a mund të sillni dëshmitarin në sallë ju lutem.

Për procesverbal, miratuam kërkesën për përdorimin e videos.

Avokate, znj. Avokate, a dëshironi ta bëjmë këtë në seancë publike apo seancë private?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Besoj që mund ta bëjmë në seancë publike, përveç në qoftë se ka ndonjë kundërshtim nga Prokuroria apo Mbrojtësi i Viktimave.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Varet shumë edhe nga pyetjet, por pastaj -- në rregull për momentin.

Tani jemi në seancë publike, shumë mirë.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e

Gjykatës këshillohen]

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët, z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Konfirmohet me dorë se na dëgjoni mirë.

Tani pyesim z. Shala, a e dëgjon dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ndëgjoj mirë, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani do të vazhdojmë me pjesën, me pyetjet e fundit të Avokates Mbrojtëse. Videoja që keni bërë është pranuar, kështu që do të bëhen disa pyetje lidhur me të.

Kam edhe një koment, vërejtje për Avokaten Mbrojtëse. Dëgjova diçka në video, të cilin do desha të sigurohem që nuk është problem për juve që ky zë të dëgjohet në seancë publike.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Besoj që për neve s'është problem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Dëshmitar, që të theksojmë, që të jeni në dijeni, jemi në seancë publike. Kështu që tregoni kujdes kur të përmendni emra apo gjëra të tjera.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokatja Mbrojtëse, keni fjalën ju.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Nëse mund të shfaqim në ekran videon që është me numrin ERN DPS01727, dhe ta lëshojmë atë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, shfaqni në ekran dokumentin e kërkuar.

A e shihni imazhin?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po, e shoh.

[Luhet videoincizimi]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të vazhdoni.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim]

PY. Z. Horne, a mund të përshkruani atë që sapo pamë?

PË. Ajo që patë jam unë, duke shtënë me një Kallashnikov, e vënë në mënyrë automatike siguresa. Dhe kisha karikuar tre fishekë në karikator. Kur bëra të shtënat, qëllimi i këtij demonstrimi ishte të tregojmë që edhe pse të shtënat bëhen në mënyrë shumë të shpejtë njëra pas tjetrës dallohen, duke dëgjuar zhurmën, dallohet qartë secila prej këtyre të shtënave.

PY. Faleminderit z. Dëshmitar.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Tani në qoftë se mund të kalojmë tek dokumenti i dytë që kemi nxjerrë sot që është me ERN, numër ERN DP01728. Me lejen tuaj, znj. Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

Sekretare, ju lutem shfaqni në ekran dokumentin e kërkuar.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, e shihni imazhin?

PË. Po.

PY. Mund të na thoni se çfarë është ky?

PË. Imazhi që shohim është shënjestra që kisha vënë për të goditur. Distanca ime nga kjo shënjestër ishte tre metra. Dhe qëllimi im ishte që të shtënat të arrinin në këtë shënjestër. Siç e sqarova më herët përpara Gjykatës mund të jetë e vështirë që të kontrollosh një armë automatike AK-47 duke shtënë në mënyrë të njëpasnjëshme, pra automatike. Dhe ky pra është ilustrim i kësaj gjëje.

E shtëna e parë është ajo që është poshtë nën pikën e kuqe, e shtëna e dytë është sipër pikës së kuqe dhe e treta është afër cepit të shënjestrës. Mund të konfirmoj që përmasat e kësaj shënjestre janë në letër A4, faqe A4.

Dhe edhe pse kam qenë tre metra nga shënjestra ndihmon Gjykatën që sa më larg të jeni nga shënjestra, aq më e madhe do bëhet distanca mes këtyre të shtënave. Dhe ka një lidhje të drejtpërdrejtë, pra, po isha gjashtë metra larg shënjestrës, distanca mes këtyre të shtënave do të dyfishohej edhe ajo. Me fjalë të tjera, distanca mes të shtënës një dhe dy do të dyfishohej nga ajo që shihet në imazh, dhe distanca mes pikës dy dhe tre do të dyfishohej.

Pra sa më larg që të jeni nga shënjestra, aq më i madh

është rreziku që të mos jenë në gjendje të arrini në shënjestër një hapësirë, në një përmasë kaq të vogël.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A mund të na thoni, cili do të ishte efekti kur qëllohet nga një distancë e afërt, më e afërt se tre metra?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më e afërt se kjo?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim]

PY. Më e afërt se tre metra.

PË. Po të jemi më afër se tre metra, të shtënat do të jenë, pikat e goditjes do të jenë më afër njëra-tjetrës, po të ishim pra nga gjysma e kësaj distance, nga një metër e gjysmë distancë, atëherë përgjysmohet edhe distanca mes pikave të goditjes.

Pra, sa më afër shënjestrës, aq më shumë janë mundësitë që të shtënat të jenë afër njëra-tjetrës.

PY. Faleminderit. Dhe për të sqaruar diçka që keni thënë, thatë në mëngjes. Thatë -- dhe është në transkriptin e përkohshëm sot në mëngjes, faqja 32, rreshti 27 [Sipas përkthimit]. Ju thatë që:

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Avokate, transkripti nuk po funksionon. Për këtë arsye ju

ndërpreva.

Vlen kjo dhe për të tjerët? Është ndaluar dhe tek ju. Atëherë, do pyes znj. Sekretare.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh që u rregullua transkripti.

Znj. Avokate e keni fjalën ju përsëri. Që të sigurohemi me z. Dëshmitar, që e kuptoi pyetjen.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Mund ta përsëris pyetjen.

DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim]

PY. Sot në mëngjes deklaruat -- dhe kjo gjendet në transkriptin e sotëm në faqen 32, rreshtat 10, 11. Thatë:

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Preferoj të kalojmë në seancë private.

Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private, ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Znj. Prokurore, a jeni gati të vazhdoni me pyetjet tuaja për dëshmitarin tani?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Atëherë, vazhdojmë kështu. Përpara se t’ju jap

fjalën, Trupi Gjykues do të japë një vendim gojor lidhur me kërkesën e Prokurorisë për të përdorur katër dokumente të nxjerrur rishtazi në pyetjet e tyre ndaj dëshmitarit, dokumentet e nxjerra të premten e kaluar. Konstatojmë se Mbrojtja nuk ka kundërshtime për përdorimin e këtyre dokumenteve si të tilla, por parashtron se dy prej tyre duhet të duhej të ishin nxjerrë më herët, shumë më herët në këtë proces gjyqësor. Dokumentet janë me ERN 072508-01-TR.

Gjithashtu Mbrojtja theksoi, përmendi dhe një dokument tjetër që duhet të ishte, sipas tyre, dorëzuar më herët, sipas rregullës 103 të Rregullores.

Gjykata, për rrjedhojë urdhëron ZPS-në që të vazhdojë të rishikojë dokumentet e tyre që kanë ata dhe që janë relevante për këtë, me qëllim që të sigurohet respektimi i të drejtave të të akuzuarit.

Trupi Gjykues në këtë pikë nuk konstaton që është e nevojshme të udhëzohet ZPS-ja që të rishikojë materialin e provës që kanë, sepse ZPS-ja pranoi se këto materiale duhet të ishin zbuluar më herët.

Trupi Gjykues lejon ZPS-në që të përdorë këto me dëshmitarin, këto materiale me dokumentet e reja të zbuluara në pyetjet e tyre ndaj dëshmitarit sepse janë të kufizuara në numër, sasi, gjatësi, dhe në kornizën e përdorimin e tyre dhe Mbrojtësi, Avokati Mbrojtës dhe Mbrojtësi i Viktimave kanë patur kohë të mjaftueshme për t'i studiuar ato.

Znj. Prokurore, tani keni fjalën ju për t'i bërë pyetje dëshmitarit.

Për arsye të menaxhimit të kohës, dhe për dëshmitarin, do të vazhdojmë deri në orën 13.00. Do të bëjmë pushimin deri në orën 14.30, dhe pastaj do të bëjmë seancën e fundit të ditës.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo:

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

PY. Mirëdita z. Horne. Më quajnë Gaia Pergolo, jam një prej Prokurorëve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Do t'ju bëj disa pyetje sot.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem që të kalojmë në seancë private. Sërish për arsye të parashtruar më përpara nga Mbrojtja për të evituar identifikimin e incidenteve të veçanta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F793*

PY. Faleminderit. Kam disa pyetje që kanë të bëjnë me disa prej armëve për të cilat diskutuam sot paradite. Pikësëpari dëshiroj që të sqaroj diçka për ne. Mund të jenë shumë të qarta për ju, por jo për ata të cilët nuk janë mësuar me armë. Dëshiroj që të di se cili është dallimi midis Kallashnikovit dhe pushkës tip AK-47?

PË. Është e njëjta gjë, thjesht janë dy emërtime të ndryshme. Pushka tip Kallashnikov është zhvilluar nga një person rus, quhej Nikolai [Sipas përkthimit] Kallashnikov. Projekti i tij ishte shumë i suksesshëm, kështu që u kopjua nga një sërë vendesh të tjera të botës, vendet e Bllokut të Lindjes. Ka një sërë të ashtuquajturash variante të Kallashnikovit që në parim është i njëjti projekt, i njëjti model, por mund të ketë dallime kozmetike apo ndonjë përmirësim tek-tuk. Por, në përgjithësi këto të gjitha quhen ose Kallashnikov ose AK-47.

PY. Faleminderit shumë. E thënë shumë thjesht, pa hyrë në shumë hollësi teknike, a do të ishte e mundshme që të na jepni një ide mbase të karakteristikave bazë të pushkës tip AK-47, kalibri për shembull?

PË. Kalibri është 7.62 milimetra. Ky është diametri i fishekut. 6.62 [Sipas përkthimit] është diametri i fishekut, por në këtë rast fishek unë e kam për plumbin, unë e di që në

disa raste njerëzit ngatërrojnë plumbin me të gjithë fishekun. Por, në fakt, e kisha fjalën për plumbin, jo për të gjithë fishekun, pra plumbi është predha që del nga fisheku, nga gëzhoja.

PY. Faleminderit shumë. E thënë përsëri në terma të thjeshtë, mund të na jepni një ide për shpejtësinë dhe kahun e shpejtësisë të një plumbi të qëlluar me një armë tip AK-47?

PË. Në përgjithësi është 2200 deri në 2300 këmbë për sekondë, e kam fjalën për municione standarde të armës tip AK-47. Mirëpo, prodhohet në vende të ndryshme. Vende të ndryshme prodhojnë municionin sipas standardeve të tyre, kështu që mund të ketë ndonjë luhatje të shpejtësisë. Por në përgjithësi pak a shumë këtu është, 2200-2300 këmbë për sekondë.

PY. Faleminderit. Më herët kolegët e Mbrojtjes ju bënë një pyetje lidhur me modalitetet e qitjes me armën tip AK-47. Ju shpjeguat në faqen 19, rreshtat 9 deri në 11 se kur përzgjedhësi i zjarrit të armës tip AK-47 është në qitje automatike, mjafton që të shtypet këmbëza -- dhe në fakt këtu dua të bëj një korrigjim për transkriptin, sepse në transkript ishte për shembull "heqje e gishtit nga këmbëza", por mbase dua që ta konfirmoj, kur e shtyp këmbëzën arma vazhdon që të bëjë qitje deri në momentin e lëshimit, pra të heqjes së gishtit nga këmbëza.

PË. Po, kështu është.

PY. Mirë pra, e bëra këtë sqarim që të jemi të qartë. Mos

vallë do të thotë kjo se në qitjen automatike qitësi mund të nxjerrë një numër të caktuar plumbash, nuk e di, 2, 3, 5, 15 në vartësi të asaj që vendos qitësi?
PË. Po, por dua të sqaroj diçka për këtë.
PY. Po.
PË. Sepse këto janë qitje me dhjetë plumba për sekondë, është e vështirë që të parapërzgjedhësh qitjen paraprake dhe të jesh në gjendje që të nxjerrësh një numër të caktuar plumbash, sepse nuk reagon dot gishti dhe arma aq shpejt. Për shembull, qitësi mund të kërkojë që të bëjë një qitje automatike të njëhershme, të themi, por nuk mund të vendosë vetë se do qisë tre plumba, pesë plumba apo dhjetë plumba.
PY. Faleminderit. Më herët sot paradite gjithashtu folët për dy lloje të veçantë automatikësh, Uzi dhe Skorpionët, në qoftë se ju kujtohet.
PË. Po, për të sqaruar për Gjykatën, Uzi është automatik, por Skorpioni është pistoletë automatike. Pra, Skorpioni mund të, me Skorpionin bëhet qitje me një dorë, ndërsa me Uzin duhet të përdorësh të dyja duart. Është një dallim teknik për të cilin desha t'ju jap sqarim, që të reflektohet siç duhet.
PY. Faleminderit shumë. Sa i takon pamjes fizike, a mund të na i përshkruani këto dy armë, përgjithësisht?
PË. Uzi është një armë shumë më e madhe se Skorpioni. Ka një qytë të palosshme, pra mund të bësh qitje sikur të jetë pushkë, duke e vendosur qytën në sup. Ka një karikator

madhosh, kështu. Karikatori mban 30 fishekë, mos gaboj. Ka, merr një municion të kalibrit 9 milimetra, të tipit Luger.

Skorpioni është pistoletë, është shumë më e vogël. Qitjen e bën me një dorë. Ka një qytë të palosshme të vogël, të cilën mund ta hapësh, ta shpalosësh, dhe ta mbështesësh në sup, por është shumë më e vogël në dimension. Mbase kështu me përafërsi mund të them se Skorpioni është sa një e dyta në masë, të themi kështu, në dimension më saktë, në krahasim me Uzin.

PY. Faleminderit. Sa i takon gjatësisë, ku qëndron Uzi në raport me AK-47? Në pamje fizike e kam fjalën.

PË. Uzi është më i shkurtër se arma tip AK-47. Sigurisht ka armë AK-47 me qytë të palosshme, ekzistojnë edhe këto. Nuk e di nëse mund t'jua tregoj me duar, AK-ja është kaq e madhe, Uzi është kaq e shkurtër. Pra ka një dallim të qartë në dimension dhe në pamje.

Karakteristika tjetër që e bën të lehtë dallimin midis Uzit dhe armës AK-47 është trajta e karikatorit. Uzi e ka karikatorin e drejtë, që zgjatet nga dorëza e pistoletës, ndërsa arma tip AK-47 e ka karikatorin të lakuar në trajtë bananeje. Dhe kjo është një karakteristikë që mund ta, prej së cilës mund ta dallojnë njerëzit që nuk e njohin, është pikërisht ky karikatori në trajtë bananeje të themi, që mban 30 fishekë brenda në përgjithësi.

PY. Faleminderit. Lidhur me këtë që sapo thatë ju, a mund të thoshim të njëjtën gjë që kur zgjatet qyta e palosshme, kur e

shpalos, është në, si qëndron në raport gjatësie?

PË. Po përpiqem të kujtoj tashti, kur i kam parë pranë njëra-tjetrës. Prapë, është më i shkurtër Uzi se arma tip AK-47, pra nëse i krahasojmë me qytë të shpalosur të dyja, ose me qytë të palosur të dyja, Uzi prapë është më e shkurtër.

Duhet të informoj Gjykatësit gjithsesi se ka variante të ndryshme të armës AK-47 që janë më të shkurtra. Për shembull janë prodhuar në versione më të shkurtra. Hungarezët, fjala vjen, kanë version me tytë më të shkurtër të armës tip AK-47. Edhe jugosllavët kanë pasur një version më të shkurtër të armës tip AK-47 të quajtur karabinë, që ishte më e shkurtër se pushka standarde tip AK-47.

PY. Faleminderit.

Meqenëse po flasim për armën tip Skorpion, po Skorpioni, ju e thatë faktikisht diçka përpara, por për ta pasur të qartë, ku qëndron Skorpioni në raport me armët e tjera, pra armën tip AK-47, sa i takon shpejtësisë, forcës qitëse?

PË. Skorpioni është armë brezi. Edhe kalibrin e ka të tillë. Fisheku është shumë më i vogël, edhe shpejtësia në grykë të tytës e Skorpionit është shumë më e vogël diku tek 1000 këmbë për sekondë. Edhe plumbi është më i vogël.

Skorpioni, me Skorpionin mund të qëllosh diku te 15 plumba për sekondë. Pra është më shpejt se AK-47, mirëpo kalibri është kalibër i armës së brezit, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, kemi ne një pyetje.

Kalibri i plumbit të Skorpionit sa është?

DËSHMITARI: [Përkthim] Quhet 7.65 në standardin, në etalonin ndërkombëtar pra në metra, dhe 0.32 në standardin imperial, pra perandorak, atë anglez, anglo-sakson. Nëse flas,

në rastin e gëzhojës kemi 19 milimetra, ngaqë është kalibri 9 milimetra. Pastaj në rastin e kalibrit të pushkës, Kallashnikovi, kemi 7.62 milimetra, por është gëzoja që është më e madhe, 39 milimetra. Sa më i madh është gëzhoja aq më shumë barut mund të futësh brenda. Pra lëndë plasëse, dhe aq më larg shkon plumbi në dallim nga gëzhoja e armës më të vogël që është 19 milimetra e gjatë.

PY. Faleminderit. Tani kam një pyetje lidhur me armën e brezit tip TT. Nuk e di nëse quhet kështu kjo armë?

PË. E keni fjalën për armën tip TT-33?

PY. Po.

PË. Po.

PY. Kjo lloj arme, a mund të mbahet në xhep, apo në brez?

PË. Po, është armë brezi, është projektuar pikërisht për t'u mbajtur në një këllëf brezi, por po të duash mund ta mbash edhe në xhep.

PY. Faleminderit shumë.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj t'i tregoj një video të shkurtër dëshmitarit për qëllime identifikimi, ta pyes në qoftë se mund të identifikojë ndonjë prej armëve për të cilat kemi diskutuar sot në këtë pjesë të videos.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, mundet znj. Prokurore, po t'ia jepni numër ERN znj. Sekretare.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Patjetër. Është materiali 5 në

listën tonë, me numër ERN 072508-01.

Mbase mund të shkojmë në minutën 05:50 dhe ta luajmë deri në 06:15, pastaj do t'ju kërkoj që ta ndaloni në një minutë të caktuar. Por ju lutem t'i luani këto sekonda, t'i shfaqim këto sekonda që t'i shikojë dëshmitari.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që të sigurohem, z. Dëshmitar, e keni videon përpara?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, atëherë. Mund të vazhdojmë.

[Luhet videoincizimi]

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit. Ju lutem të kthehemi tek minuti 06:00 dhe të kemi vetëm një kuadër aty. Kuadrin në atë minutë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, mbase pak sekonda pas kësaj.

[Luhet videoincizimi]

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Pikërisht kjo.

PY. Z. Dëshmitar, a i njihni mes këtyre armëve ndonjë prej armëve për të cilat diskutuam sot?

PË. Po.

PY. Cilat?

PË. Do të filloj nga e majta. Arma në të majtë është AMD-65,

prodhim hungarez. Është versioni me tytë të shkurtër të cilët hungarezët e zhvilluan, e kanë prodhuar për desantët.

Pastaj kemi dhe karikatorët e armës tip AK-47, janë të mbështjellë me ngjitëse së bashku, janë përshtatur pra që të kenë më shumë kapacitet.

Pastaj kemi armën tip AK-47 ajo që është me kasën ngjyrë të kafenjtë. Nuk jam shumë i sigurt, por mua më duket si një prodhim i Gjermanisë lindore, AK-47, MK IMS, më duket.

Por pastaj, përbri kësaj kemi dy pistoleta. Por nuk jam krejt i sigurt për pistoletën sipër, më duket si një pistoletë ushtarake faktikisht. Por pistoleta poshtë saj mund të jetë modeli TT-33, ose Tokarevi ose versioni jugosllav i modelit TT që më duket se quhet M57.

PY. Faleminderit shumë.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mund ta heqim videon tani. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

PY. Z. Horne, dëshiroj që të diskutojmë tani për atë që ne e kemi quajtur *[REDAKTUAR]*. Konstatimet në faqen 6 dhe 7 të raportit tuaj, me numër DPS00864 deri në DPS00875.

Sot pra kemi diskutuar për Kallashnikovët. Ju na folët që këto janë armë, apo pushkë mësymëse. Ato gjithashtu kanë edhe zmbrapsjen e armës. Na folët dhe për këtë. Është në faqen 27,

rreshti 4.

Dua t'ju pyes dhe një herë, mund të na shpjegoni se ç'lloj lëvizjeje krijohen zmbrapsja e armës së zjarrit normalisht?

PË. Për çdo forcë ka një kundërforcë, çdo lëvizje ka një kundërlëvizje. Nëse bën një përllogaritje të, në bazë pra, shumëzon masën me shpejtësinë e plumbit, dhe kjo do të duhej që të ishte e barabartë me masën dhe shpejtësinë e armës. Pra, nëse plumbi që del nga gryka e armës ka një shpejtësi të caktuar, atëherë ky shumëzim, pra prodhimi i këtij shumëzimi do të jetë i barabartë me shumëzimin e prodhimit midis masës dhe shpejtësisë së armës. Por plumbi është i lehtë, është i vogël, kështu që arma që lëviz në drejtimin e kundërt të plumbit, pra lëviz më pak se është më e rëndë, kjo lëvizje e armës quhet zmbrapsja e armës.

PY. E qartë, faleminderit.

Zmbrapsja e armës a ka ndonjë efekt tek qitësi?

PË. Qitësi e ndien zmbrapsjen ose si një shtytje apo si një goditje në sup, sepse arma shkon pas dhe për një moment të shkurtër e ndryshon shënjestrën. Për shembull nëse ti bën qitjet me një plumb, atëherë për shkak të zmbrapsjes, atëherë shënjestra e armës zhvendoset nga objektivi yt dhe të duhet që ta rrafshosh prapë shënjestrën për herë të dytë që të gjuash prapë tek i njëjti objektiv.

Me një armë automatike kjo ndodh shpejt dhe qitësi nuk ka

mundësi që ta korrigjojë shënjestrën për shkak të qitjeve të njëpasnjëshme me shpejtësi të armës.

PY. Faleminderit. Një qitje, apo një batare që del nga gryka e armës tip AK-47 në distancë të afërt, a shkakton ndonjë reagim apo lëvizje tek personi që goditet nga plumbat?

PË. Jo, mund të reagojë personi sepse ndien diçka, por vetë plumbi nuk shkakton dot reagim.

Për shembull, unë e di që ekziston ky, kjo ide e gabuar që është shpërndarë nga kinematografët, domethënë që i shikojmë, kur shikojmë filma, kujtojnë se kur e qëllon dikë me plumb lëviz trupi fizikisht, por nuk ka lëvizje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh që është ngritur Avokatja, që është ngritur në këmbë.

A ka nevojë ta nxjerrim dëshmitarin?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Jo, po flasim në përgjithësi për këto armë, nëse po flasim në përgjithësi, mund ta bëjmë në formë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, njëherazi kemi një numër të madh njerëzish në galeri dhe nuk e di se çfarë problemesh do dalin më mbrapa, nëse do na duhet që të redaktojmë diçka, vlera e redaktimit të materialit me një publik kaq të madh të pranishëm është e komplikuar.

Vetëm nëse Prokurorja është vërtet e sigurt që nuk do të ketë asgjë e cila mund të lidhet me incidentin në fjalë, sepse më përpara për shembull na është dashur që të bëjmë dy

redaktime, sepse ju i keni parë redaktimet, nuk ka nevojë që t'i shpjegoj. Është shumë e vështirë. Mirëpo atëherë nuk ishte askush në galerinë publike.

Por ju kuptoj tashti, por duke pasur parasysh sa delikate është çështja, masat që kemi tani në zbatim unë do isha më se hezituese, nuk jam e bindur në këtë moment.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse. Në fakt pjesa ku do kalojmë tani menjëherë mbas kësaj pyetjeje me gjasë do të flas më me hollësi për aktekspertizën e autopsisë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por të jeni e qetë se të njëjtin shqetësim që keni ju e kam edhe unë sepse ka shumë mundësi që një pjesë e kësaj seance mund të riklasifikohet më mbrapa, patjetër.

Në rregull, atëherë. Ju, lutem, znj. Prokurore, mund të vijoni.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit shumë.

PY. Z. Dëshmitar, ju shpjeguat pra në vetvete se vetë plumbi nuk ka ndikim te trupi. Pra nuk shkakton lëvizje të trupit, por siç e thatë në faqen 57, rreshti 9 dhe 10, mund të reagojë personi ngaqë ndien diçka, kjo është mundësia?

PË. Po. Nëse mund ta ndihmojë Trupin Gjykues, mund të them që e kam parë, për shembull, që kur një person *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* që e kanë gjuajtur armë zjarri më të fuqishme se arma AK-47, dhe për ta

dëshmuar këtë ai qëndronte me një këmbë dhe edhe pse u godit me armë, nuk e humbi ekuilibrin. Kjo është për shkak të masës së trupit, 70-80 kilogramë, në krahasim me plumbin që plumbi është vetëm 10 gramë.

PY. A do të kishte ndonjë dallim nëse personi do të qëllonte me armë AK-47 *[REDAKTUAR]*

PË. Jo, s'do kishte asnjë ndryshim.

PY. Dhe sa i takon reagimit të, që mund të kishin plumbat mbi këtë person, si do reagonte personi?

PË. Mund të tërhiqej personi, mund të largohej, mund të ndiente dhimbje, mund ta lëvizte trupin anash ose në ndonjë drejtim tjetër, por kjo do të ishte një lëvizje që e bën personi dhe nuk e bën plumbi.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jeni në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë faleminderit, znj. Sekretare.

Znj. Prokurore, dhe sa kohë mendoni se ju duhet për të përfunduar me pyetjet tuaja për dëshmitarin?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Maksimumi disa minuta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtësi i Viktimave keni pyetje për dëshmitarin?

Z. LAWS: [Përkthim] Po, kemi pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa kohë mendoni se ju nevojiten?

Z. LAWS: [Përkthim] Na duhet thuajse rreth 20 minuta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, faleminderit.

Avokati i Mbrojtjes, e dimë se është herët se s'kemi përfunduar me pyetjet akoma, por nuk e di nëse keni pyetje plotësuese, si mendoni?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Është shumë herët për ne për të thënë, do të duhet që të dëgjojmë të gjitha pyetjet nga të

gjitha palët pastaj për të arritur në një përfundim në qoftë se na duhen pyetje plotësuese apo jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dëshmitar, do bëjmë pushim për një orë e gjysmë, deri në orën 14.30. Do shihemi përsëri në atë orë bashkë. Faleminderit.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala, dëshironi -- e shoh që z. Shala do të thotë diçka, por përpara kësaj le të shoqërojmë dëshmitarin nga salla e gjyqit, të dalë nga salla e gjyqit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala, jemi në seancë publike, që ta dini. Çfarë dëshironi të thoni?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Vetëm nji konsultë me Avokatin, në qoftë se është mundësia të më bëhet e mundur, për kohën e pushimit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pa diskutim. Gjatë pushimit keni mundësi që të diskutoni me Avokatin tuaj. Avokatët e dëgjuan, kështu që jam e sigurt që do kontaktojnë me ty. Jam e sigurt që do kontaktojnë me ty, z. Shala.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Ju faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit ju, z. Shala. Do bëjmë pushim deri në orën 14.30.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

Faleminderit.

--- Pauza e drekës fillon në orën 12.58

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk shoh ndonjë ndryshim në përbërjen e ekipeve dhe këtë e thashë për procesverbal.

Mirë se erdhët përsëri të gjithëve!

Z. Shala, na dëgjoni mirë? Mirëdita. Na dëgjoni z. Shala?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita. Ju dëgjoj shumë mirë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull atëherë. Vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit-ekspert.

Znj. Asistente e Seancës, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

Znj. Prokurore, do të vazhdoni dhe për disa minuta, kështu sikur e kuptova, është e saktë kjo?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Kemi disa pyetja të tjera përpara sesa të përfundojmë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Dëshironi që të kalojmë në seancë private?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mirë se erdhët! Më dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju dëgjoj mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Z. Shala, e dëgjuat përkthimin e asaj çfarë tha dëshmitari?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, po. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Përpara se t'i jap fjalën Prokurores që të vazhdojmë me pyetjet e radhës për dëshmitarin, do i kërkoja Sekretares së Seancës të na kalojë në seancë private.

Mund të na kaloni në seancë private, znj. Sekretare?

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Kemi ardhur kështu në fund të dëshmisë tuaj, z. Dëshmitar. Dëshiroj t'ju falënderoj për përpjekjet tuaja për të dhënë dëshmi përpara këtij Trupi Gjykues. Ju falënderoj për këtë. Ju rikujtoj se për dëshminë tuaj nuk duhet të diskutoni me asnjë person tjetër.

Znj. Asistente e sallës do t'ju shoqërojë që të dilni nga salla.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

Në rregull. Do të vijojmë nesër. Pra, ditën e martë me -- dëshmitarin e Mbrojtjes me numër 4280. Sa i takon këtij dëshmitari dëshiroj që të kalojmë një çast në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Prokuroria ka diçka për të ngritur para Trupit Gjykues?

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F729RED dhe F793.*

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, asgjë, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtëse i Viktimave?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, asgjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala Mbrojtëse?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Asgjë, faleminderit shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë bëjmë këtu ndërprerjen e seancës. Do të ritakohemi nesër në orën 09.30.

--- Seanca mbyllet në orën 15.32